



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 167 Prot.

Tiranë, më 02 / 11 / 2023

VENDIM

Nr. 59, Datë 02. 11. 2023

**“PËR ZVËNDËSIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT ZJEDHOR TË
FAKULTETIT TË MJEKËSISË DENTARE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË,
TIRANË”**

Në bazë të nenit 7 të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” e ndryshuar, Urdhrin nr. 160, datë 20.10.2023 të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Vendimit nr. 57 të KIZ, datë 23.10.2013, Vendimit nr.58, të KIZ datë 25.10.2023 dhe në aplikimet e dorëzuara për zvëndësimin e anëtarëve të KZF-FMD të larguar për shkak të përfundimit të studimeve (kategoria student) apo daljes në pension/largimit/ndryshimeve eventuale (personel akademik), KIZ në mbledhjen e datës 02.11.2023, pasi mori në shqyrtim aplikimet e dorëzuara në sekretarinë e tij nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e znj. **Rozela Xhemica** për kalimin nga pozicioni Sekretar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare (KZF) në anëtar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare (KZF) në Universitetin e Mjekësisë, kategoria personel.
2. Të shpallë fitues dhe të caktojë si Sekretar të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare (KZF) në Universitetin e Mjekësisë, znj. **Gresa Baboçi**.

3. Të shpallë fitues për anëtar i Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Mjekësisë Dentare (KZF) në Universitetin e Mjekësisë, kategoria student, znj. **Inva Idrizi**.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, një kopje i dërgohet KZF-FMD të UMT, afishohet në ambientet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit.
5. Ngarkohet KZF- FMD, të kryejë procedurat e zgjedhjes së Kryetarit të KZF, zvendësimit dhe përfshirjes së anëtarëve të rinj në procesin e zgjedhjeve për Komisionet e Përhershme për dhënien e gradës shkencore “Doktor”

**KRYETAR
SILVANA BALA**

